

24 - 09 - 2018

P.nr.2480/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I
PERGJITHSHEM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin e vetëm gjykues

Illir Bytyqi si dhe me procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhu me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.960-7/2017 dt.03.10.2017, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, si dhe të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] më datë 13.07.2018 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 27.07.2018 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1. [REDACTED], i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Rr. [REDACTED], në Ferizaj, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar si kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar. Shtetas i Republikës së Kosovës.
2. [REDACTED], i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Rr. [REDACTED], në Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së mire ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

Me datë 17 Prill 2017, rreth orës 16:30, në objektin e Shkollës Fillore "Gjon Serreçi" në Ferizaj, me rastin e kontrollimit nga ana e zyrtarëve policor për derisa të pandehurit ishin duke qëndruar së bashku me të miturin [REDACTED], tek të njëjtit është gjetur dhe sekuestruar një cigare e mbështjellë me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 0.52 gram, e të cilën e kanë poseduar pa autorizim dhe ishin duke e konsumuar që të gjithë së bashku.

me këtë ka kryer veprën penale në bashkëkryerje posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,49,50,51,52,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, të pandehurit i

G J Y K O N

Të pandehurit:

- [REDAKTUAR] dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /treqind/, i cilin dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 /një/ Viti, në qoftë se të pandehurit gjatë kësaj kohe nuk do të kryejnë veprë penale.
- [REDAKTUAR] dënim me gjobë në lartësi prej 300 Euro /treqind/, i cilin dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 /një/ Viti, në qoftë se të pandehurit gjatë kësaj kohe nuk do të kryejnë veprë penale.
- Konform, nenit 275 par. 3 të KPRK-së, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuan në peshë neto 0.52 gram.
- Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 40 Euro /katër dhjetë/, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, të ligjit Nr. 05/L-036 për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj

gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.II.nr.960-7/2017 dt.03.10.2017, ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj të tre nga Ferizaj, për veprën penale në bashkëkryerje posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 2 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.07.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale, ndihet thellë i penduar, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë, ndërsa i akuzuari [REDAKTUAR] e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale, ndihet thellë i penduar, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë.*

Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'iu shqipton dënimin e merituar.

Me që të pandehurit kanë pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par. 1 (edhe përkundër udhëzimeve nga neni 323) të KPPK-së: të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të pandehurit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndes siç janë:

Ekspertiza e Agjencionit të Forenzikës AKF/2017-2144/2017-1922 e dt.15.09.2017, Raporti i Oficerit 2017-DHTN-227 e dt. 18.04.2017, Deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt. 07.04.2017, Deklarata e të pandehurit [REDAKTUAR] e dt. 17.04.2017, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Me qenë se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: 17 Prill 2017, rreth orës 16:30, në objektin e Shkollës Fillore "Gjon Serreçi" në Ferizaj, me rastin e kontrollimit nga ana e zyrtarëve policor për derisa të pandehurit ishin duke qëndruar së bashku me të miturin [REDAKTUAR] tek të njëjtit është gjetur dhe sekuestruar një cigare e mbështjellë me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 0.52 gram, e të cilën e kanë poseduar pa autorizim dhe ishin duke e konsumuar që të gjithë së bashku.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale përdorimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, meqë me datat, vendet dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin të këtij aktgjykimi i pandehurit me dashje direkte ka konsumuar elementet e veprave penale të lartshënuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar kanë pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, janë të moshës së re, kanë ra ndesh për herë të parë me ligjin respektivisht nuk ka dëshmi se janë gjykuar me vendim të formës së presë, ndërsa në mungesë të

rrethanave veçanërisht rënduesc, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurve dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

Ndërsa sa i përket të pandehuri [REDAKTUAR] konform nenit 160 dhe nenit 253 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, Gjkata me Aktvendim të veçantë ka pushuar procedurën penale pasi gjatë njëdhës së kësaj procedure ka pranuar certifikatën e vdekjes nga Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme – Sektori i gjendjes civile me numër të referencës V 10201208 dt. 03.07.2018, në bazë së cilës është vërtetuar fakti se i pandehuri tani i ndjeri [REDAKTUAR] i lindur me datë [REDAKTUAR] në Prishtinë, nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e vajzëris [REDAKTUAR] ka vdekur me datë 13.10.2017 në Ferizaj.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.


Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,
P.nr.2480/17 datë 27.07.2018.

B. Profesionale
Mimoza Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.